



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKËS  
DEKANI

Nr. Prot. 43/2

Tiranë, më 21/01 2019

R R E G U L L O R E

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT  
NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË  
“MASTER PROFESIONAL” /MËSUESI  
DHE  
“MASTER SHKENCOR”/MËSUESI  
“MASTER I ARTEVE ”/MËSUESI  
NË FAKULTETIN E MUZIKËS,  
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE  
PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021

MIRATUAR ME VENDIM NR \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_  
TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë “ , Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 76 Pranimi në programet e ciklin e dytë të studimeve, si dhe mbështetur në Rregulloren e UAT të ciklit të dytë të studimeve “Master”/Mësuesi Kreu II “*Dokumenti themelor i programeve të studimit në Master/Mësuesi*” Neni 10 “*Pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë*”, konkurset e pranimit në Fakultetin e Muzikës për vitin akademik 2020-2021 do të zhvillohen si më poshtë:

### **Neni 1** **Pranimi i kandidatëve**

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve, bëhet mbi rezultatet e konkurseve që zhvillohen për studimet në ciklin e dytë të studimeve “Master”, pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj rregulloreje si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta “Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja”, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, posaçërisht për trojet Shqiptare.

### **Neni 2** **Kriteret e pranimit**

- 2.1 Të kenë kryer programin e studimit të ciklit të parë Bachelor pranë këtij fakulteti ose nga Fakultete të tjera analoge si brenda dhe jashtë vendit.
- 2.2 Pranohen të gjithë ato kandidatë që kanë kryer studimet në ciklin e vjetër 4-vjeçar në fakultetin e Muzikës. Gjithashtu edhe ato kandidatë të ciklit 4-vjeçar, të fakulteteve të tjera analoge brenda dhe jashtë vendit.
- 2.3 Për konkurrentët që kanë kryer studime jashtë vendit kërkohet njësimi i Diplomës sipas Ligjeve në fuqi.
- 2.4 Baza e konkurrimit për kandidatët në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Muzikës për studime në ciklin e dytë të studimeve “Master”, janë kriteret e miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 2.5 Kandidatët për programin e studimit Master Profesional/Mësuesi dhe Master Shkencor/Mësuesi /Master i Arteve/Mësuesi, duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Muzikës, dosjen personale të konkurrentit ku të jenë të përfshira:

- I. CV e tij/e saj,
- II. Diploma,
- III. Listën e notave të programit të studimit të kryer,
- IV. Dëshmi mbi rezultatet e arritura në procesin e realizimit të programit mësimor,



- V. Projekte,
  - VI. Koncerte,
  - VII. Pjesëmarrje të ndryshme, etj.
- 2.6 Dosja duhet të përmbajë dëshmitë e aktiviteteve artistike, si brenda dhe jashtë UAT apo IAL-ve të tjera analoge:
- I. Postera,
  - II. Fletë palosje,
  - III. Fotografji,
  - IV. Dhe çdo material tjetër që dëshmon aktivitetet artistike të konkurrentit.

### Neni 3

#### Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 3.1 Dekani i Fakultetit, mbështetur në propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 3.2 Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 3.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
  - I. Titullarë të fushës përkatëse,
  - II. Pedagogë efektivë të Njësive Bazë përkatëse,
  - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi kur nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij Neni.
- 3.4 Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 3.5 Në mjediset ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga titullari i Fakultetit të Muzikës .
- 3.6 Monitorimi i të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, kryhet nga grupi përkatës i ngritur me urdhër të posaçëm nga Rektori i UAT, si dhe nga përfaqësuesit e MASR.

### Neni 4

#### Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrimit.

- 4.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret sipas përcaktimeve të Nenit 2, të kësaj rregulloreje.
- 4.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët që janë regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Muzikës, brenda afatit të përcaktuar nga MASR.
- 4.3 Konkursi për Fakultetin e Muzikës do të zhvillohet në mjediset e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MASR.
- 4.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
  - I. *Kartë Identiteti,*
  - II. *Pasaportë për jashtë shteti,*



**III.** *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*

- 4.5 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të paraqesë në hyrje edhe mandat pagesën e bërë në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.
- 4.6 Në varësi të specifikave për secilin Program Studimi, komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë të ditura më parë oraret përkatëse. Oraret duhet të shpallen në ambientet e Fakultetit të Muzikës.
- 4.7 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Muzikës. Ky kalendar shpallet në Fakultet jo më vonë se një javë përpara fillimit të konkursit.
- 4.8 Kalendar i Orareve dhe Mjediseve shpallet në Fakultet një javë përpara fillimit të konkursit.
- 4.9 Ditën e parë të konkursit, pasi të jenë sistemuar në ambientet e zhvillimit të tij, kandidatëve u komunikohen rregullat e konkurrimit. Kjo bëhet nga Kryetarët e komisioneve përkatëse.
- 4.10 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 4.11 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet krijojnë hapësirën kohore të nevojshme për secilin prej kandidatëve gjatë konkurrimit.

**Neni 5**

**Mënyra e Vlerësimit**

- 5.1 Kufiri maksimal i pikëve për çdo konkurrent është gjithsej **100 pikë**.
- 5.2 Kufiri minimal i pikëve për çdo konkurrent është gjithsej **40 pikë**.
- 5.3 Ndarja e pikëve të vlerësimit sipas zërave të përcaktuara në Kriteret e Konkurrimit për çdo program studimi, bëhet me Vendim *ad hoc* të Komisionit të Vlerësimit.

**Neni 6**

**Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve**

- 6.1 Vlerësimi për çdo kandidat bëhen nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 6.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).
- 6.3 Mbas mbarimit të konkurrimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, bën vlerësimin e kandidatëve. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 6.4 100 pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të pranimit, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit.
- 6.5 Secili anëtar i komisionit të pranimit vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.



- 6.6 Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët përkatëse në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 6.7 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 6.8 Komisionet e Pranimit të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet ia dorëzojnë me procesverbal Titullarit të Fakultetit.
- 6.9 Listat përfundimtare me pikët përkatëse për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.

### Neni 7

#### Shpallja e fituesve

- 7.1 Shpalljen përfundimtare të fituesve, me pikët përkatëse, e bën Dekani i Fakultetit mbi bazën e kuotave të aprovuar nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve .
- 7.2 Në rastin kur disa konkurrues kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata nënrenditen midis tyre sipas rendit alfabetik.

### Neni 8

#### Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 8.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 8.2 Dokumentacioni për regjistrimin e kandidatëve mbahet bazuar në udhëzimin e MASR.
- 8.3 Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**.
- 8.4 Ato duhet të jenë:
  - I. Diploma Bachelor
  - II. Për kandidatët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, të njohura nga MARS dhe të noteruara.
  - III. Kartë identiteti,
  - IV. Pasaportë,
  - V. 2 ( dy ) fotografi
  - VI. Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit.
- 8.5 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 8.6 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç' regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 8.7 Kandidatit që ç' regjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 8.8 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Muzikës, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKËS  
DEKANI

Nr. Prot. 13

Tiranë, më 21.01.2019

**Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM  
Viti akademik 2020 – 2021**

**1. Programi i studimit: Master i Shkencave në Muzikologji /Mësuesi**

Konkursi për studimet e Ciklit II në programin mësimor Master i Shkencave në Muzikologji (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I
2. Mesatarja e ponderuar e notave të Ciklit I, në lëndët:
  - a. Muzikologji (nota e tre viteve, plus nota e Diplomës)
  - b. Harmoni (Pjesa I, Harmonia shek. XX, Harmoni stilistike)
  - c. Kontrapunkt (Stil i ngushtë, Stil i lirë)
  - d. Instrumentacion
  - e. Orkestracion
  - f. Analizë e formave muzikore
  - g. Histori Muzike.

Mesatarja e notës në pikat 1 dhe 2 preferohet të jetë përmbi 8 (tetë)

3. Veprimtaria artistike e kandidatit gjatë periudhës së studimeve të Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet *ad hoc* nga Komisioni i Vlerësimit.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM  
Viti akademik 2020 – 2021**

**2. Programet e studimit: Master i Arteve në Kompozim/Mësuesi dhe Master i Arteve në  
Dirigjim/Mësuesi**

Konkursi për studimet e Ciklit II në programet e studimit Master i Arteve në Kompozim dhe  
Master i Arteve në Dirigjim, zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I
2. Mesatarja e ponderuar e notave të Ciklit I, në lëndët:
  - a. Kompozim/Dirigjim (nota e tre viteve, plus nota e Diplomës)
  - b. Harmoni (Pjesa I, Harmonia shek. XX, Harmoni stilistike)
  - c. Kontrapunkt (Stil i ngushtë, Stil i lirë)
  - d. Instrumentacion
  - e. Orkestracion
  - f. Analizë e formave muzikore
  - g. Histori Muzike.

Mesatarja e notës në pikat 1 dhe 2 preferohet të jetë përmbi 8 (tetë)

3. Veprimtaria artistike individuale e kandidatit gjatë periudhës së studimeve të Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet *ad hoc* nga Komisioni i Vlerësimit.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shentu



**Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM  
Viti akademik 2020 – 2021**

**3. Programi i studimit: Master Profesional në Pedagogji Muzikore /Mësuesi**

**A. Dispozita të përgjithëshme**

1. Konkursi për studimet Master Profesional (Ciklit II) në programin Pedagogji Muzikore zhvillohet në dy faza.

**B. Faza e parë**

1. Kjo fazë përfshin shqyrtimin e dosjes së kandidatëve dhe rezultateve të tyre në programin e studimit përkatës të Ciklit I të studimeve.

**C. Faza e Dytë**

1. Faza e dytë përfshin një test integral formimi (profesional dhe të përgjithshëm) të modelit si më poshtë:

Simfonia e parë shqiptare është kompozuar nga:	Klod Debysi është kompozitor:	
	Po	Jo
a. Tish Daija	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Çesk Zadeja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Tonin Harapi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2. Koha në dispozicion për të kryer testin me shkrim është 2 (dy) orë.

3. Kërkesat për hartimin e testit integral të formimit (profesional dhe të përgjithshëm) mbështeten në syllabuset përkatëse të programit të studimit Pedagogji Muzikore të Ciklit I të studimeve.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM  
Viti akademik 2020 – 2021**

**1. Programet e studimit: Master i Arteve në Violinë/Mësuesi, Violë/Mësuesi,  
Violonçel/Mësuesi, Kontrabas /Mësuesi**

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programet e studimit Master i Arteve/Mësuesi në Violinë,  
Violë, Violonçel, Kontrabas (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, preferohet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, preferohet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual (solistik, muzikë dhome) i kandidatit gjatë periudhës së studimeve në Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM  
Viti akademik 2020 – 2021**

**2. Programi i studimit: Master i Arteve në Piano/Mësuesi**

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programin e studimit Master i Arteve në Piano (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, preferohet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, preferohet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual (solistik, muzikë dhome) i kandidatit gjatë periudhës së studimeve në Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në programet e studimit të Ciklit II në FM  
Viti akademik 2020 – 2021**

**3. Programet studimit: Master i Arteve në Flaut/Mësuesi, Oboe/Mësuesi, Klarinetë/Mësuesi, Fagot/Mësuesi, Korno/Mësuesi, Trompë/Mësuesi, Trombon /Mësuesi**

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programet e interpretimit Master i Arteve në programet Flaut, Oboe, Klarinetë, Fagot, Korno, Trompë, Trombon (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, preferohet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, preferohet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual (solistik, muzikë dhome) i kandidatit gjatë periudhës së studimeve në Ciklit I.
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimi në programet e studimit të Ciklit II në FM  
Viti akademik 2020 – 2021**

**5. Programet e studimit: Master Profesional në Bastubë, Fisarmonikë Klasike dhe Kitarë**

Konkursi për studimet e Ciklit II në Programet e studimit Master Profesional në Bastubë, Fisarmonikë Klasike dhe Kitarë (Cikli II) zhvillohet me konkurim me dosje.

Elementet që do të shqyrtohen në dosje janë:

1. Mesatarja e notës në studimet e Ciklit I, preferohet të jetë përmbi 7 (shtatë)
2. Mesatarja e Diplomës, preferohet të jetë përmbi 8 (tetë)
3. Aktiviteti artistik individual i kandidatit (solistik, muzikë dhome) gjatë periudhës së studimeve të Ciklit I
4. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga Komisioni i Vlerësimit ad hoc.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu

